

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Pozita e të kërkuarit¹ / *Mekaamul-Muraad* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

وَمَا كُنْتَ تَرْجُو أَنْ يُلْقَىٰ إِلَيْكَ الْكِتَابُ

“Dhe ti nuk pritje që të të jepej libri (Kurani).” (el-Kasas, 86)

Shumica e atyre që flasin për këtë disiplinë të dijës, trajtuan kërkuarin (*murid*) dhe të kërkuarin (*muraad*) si dy gjëra të ndryshme dhe konsideruan shkallën e *muraad* (të kërkuarit) më të lartë sesa atë të kërkuarit (*murid*). Me termin “el-muraad” ata iu referuan të përzgjedhurve në kumtimin². Ka tri nivele të të kërkuarit.

¹ *Murid* është kërkuari. *Muraad* është i kërkuari. Allahu kërkon robin për ta pastruar dhe për ta ngritur para se ai ta kërkojë Atë.

² Shejhu po i referohet një hadithi të treguar nga Ibn ebi ed-Dunja dhe të përcjellë nga Enesi ؓ, ku pejgamberi ﷺ thotë:

“Allahu përzgjedhi ndër krijesat ata që do t’i mbrojnë. Ai i mbron ata aq shumë sa as nuk i kalon nëpër sprova. Ai i bën ata të jetojnë dhe të vdesin në një gjendje të mirëqenies së plotë dhe të hyjnë në xhenet në një gjendje të mirëqenies së plotë.” (Hadith i dobët sipas Ibn Haxherit, el-Hejthemit, dhe shejh Albanit).

Koncepti i të qenët i kërkuar nga Allahu është i vlefshëm, meqë, e para e punës, ti as që do të mund ta kërkoje Atë pa të kërkuar Ai së pari. Megjithëkëtë, kjo duhet të kuptohet përbrenda kornizës së përgjithshme të drejtësisë hyjnore. Allahu tha:

“Çifutët dhe të krishterët thanë: ‘Ne jemi fëmijët e Allahut dhe të dashurit e Tij.’ Thuaj: ‘Atëherë, përse Ai ju ndëshkon për gjynahet që bëni?’ Nuk është ashtu, por ju jeni vetëm qenie njerëzore ndër ata që Ai krijoi.” (el-Ma’ideh, 18)

Në nivelin e parë, Ai mbron me zor robin që orvatet të bëjë ndonjë veprim të pakujdesshëm:³

- duke ia zvetënuar dëshirat
- duke ia bllokuar kënaqësitë
- duke ia mbyllur me forcë shtigjet e shkatërrimit

Në nivelin e dytë⁴, Ai:

- ia lehtëson robin pasojat e përkohshme të mangësive të tij
 - e kursen nga qortimi
 - e bën që t'i zotërojë pasojat e rrëshqitjeve të tij
- Siç bëri me Sulejmanin عليه السلام pasi ai vrau kuajt: Ai e barti me erë të lehtë dhe të fortë si zëvendësim për kuajt. Njësoj Ai bëri me Musën عليه السلام, kur ai hodhi Pllakat përtokë dhe mori për flokësh vëllain (Harunin), dhe nuk e qortoi sikurse qortoi Ademin عليه السلام, Daudin عليه السلام, dhe Junusin عليه السلام.

Niveli i tretë është që i Vërteti të përzgjedhë robin e Tij për (favorin e) devocionit më të madh, si atëherë kur Ai foli me Musën عليه السلام, kur ai deshi të merrte një pishtar nga zjarri i kaçubës, dhe e ktheu nga Vetja dhe nga ai la një imazh të huazuar (sa për t'u parë; sipas konceptit sunit të shpërbërjes në hyjnoren, jo sipas koncepteve të devijuara sektare).⁵

³ Ibn Ataa tha: “Nëse do që ta dish pozitën që ke te Allahu, shih ku të bëri të qëndrosh.”

Verifiko me kujdes këtë nivel që të shohësh se ku qëndron ti karshi Allahut. Mirëpo, të kesh parasysh se Zoti mund të dëshirojë ta testojë vendosmërinë e robërve, kështu që ua intensifikon sprovat. Pasja e vështirësisë në përpjekjen tënde kundër gjynahut mund të rezultojë në ngritjen tënde; ai që kënaqet me gjynahun duke mos ndier keqardhje, është larg nga Allahu në ato çaste.

⁴ Në nivelin e parë thamë se Ai e mbron (të kërkuarin) nga gabimi. Mirëpo, ndodh që, edhe atëherë kur më i dashuri i Tij të bëjë gabime, Ai ta kursejë nga të gjitha pasojat. Në vend të kësaj, Ai mund ta ngrejë në grada më të larta nëpërmjet, për shembull, thyerjes që ai pëson para Tij dhe keqardhjes që ndien.

⁵ Emri i tij, trupi i tij, cilësitë e tij, etj., domethënë ekzistencën e tij të përbotshme me të cilën ai është identifikuar dhe njohur nga pjesa tjetër e krijesave. A mund të bëjmë ne diçka për të cilën do të shiheshim nga Ai me syrin e mëshirës? Pejgamberi ﷺ tha:

“Kërkoni të mirën gjatë jetës dhe ekspozojuni puhisë së mëshirës së Zotit tuaj, se Allahu bën që puhia e Tij të prekë kë të dojë Ai.” (Përcolli Ebu Nu’ejm nga Ebu Derda).

Kërko kohët, vendet, dhe rrethanat ku ti mund të prekesh nga këto lulëzime të mëshirës së Tij.